



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



## EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 23.12.2022,  
duke filluar në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Fehmi Kupina, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri dhe Mirsad Vitia.

**Mungoi:** Bahri Gashi.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Donjeta Sahatçiu, nënkryetare e Komunës, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtore e Drejtorisë së Financave, Besianë Musmurati, drejtore e Drejtorisë së Arsimit, Plator Gërdovci, drejtor i drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Dukagjin Gashi, përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Osman Bllaca.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Besianë Masmurati** propozoi të futet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për plotësimndryshimin e Vendimit për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, nr. 01-151/01-151637/22, të dt. 30.06.2022.

**Gëzim Sveçla** propozoi të futet si pika të rendit të ditës "Raporti i punës së Kryetarit, për periudhën 7 dhjetor 2021 – 7 dhjetor 2022" dhe "Propozimvendimi për plotësimndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-020/02-103516/22, më 12.05.2022".

Po ashtu, theksoi se është kthyer si i paligjshëm Vendimi për ndarjen e parcelës për Universitetin e Prishtinës. Këto vendime që po kthehen paligjshëm prej MAPL-së si pasojë se ne nuk po veprojmë sipas udhëzimeve të cilat parashihen nga ligji, por edhe nga MAPL-ja në këtë rast, si po procedojmë me këto raste.

**Leutrim Retkoceri** tha se është një vendim që ka ardhur nga Ministria e Ekonomisë. Sa i përket vendimit për caktimin e tarifave për deponinë e mbeturinave, besoj se është Dukagjini që mundet me dhënë si informatë shtesë se çka ka ardhur.

Faqe1nga10

**Dukagjin Gashi** dha sqarime, duke thënë se është një ndryshim për deponimin e mbeturinave, që Ministria e ka marrë vendimin, konkretisht Ministria e Ekonomisë, ku prej 5.31 euro për ton të mbeturinave, tash secila kompani obligohet të paguajë shumën prej 7.31, d.m.th. për 2 euro është ngritja. Përveç kësaj, parashihet edhe një ngritje vjetore nga 1 euro për vit deri në vitin 2027.

**Osman Bllaca** pyeti Dukagjinin se me çka e kemi të përcaktuar çmimin e tarifës, plotësim-ndryshimi i asaj rregulloreje si quhet dhe a është vetëm për ekonomi familjare.

**Nora Kelmendi** pyeti Dukagjinin se a e keni formuar komisionin për ndryshimin e rregullores, përndryshe prapë ua kthen Ministria nëse veç e ndryshoni pa komision.

Lidhur me pyetjet e parashtruara nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Dukagjin Gashi**.

**Jeta Rafuna** tha sa i përket këtij propozimvendimi, mendoj që na nevojitet pak më shumë analizë, duke e pasur parasysh që edhe Zyra ligjore nuk qenka këtu. Për të mos rënë në lajthitje, propozoj që kjo pikë të futet në seancën e radhës, në janar.

**Donjeta Sahatçiu** tha se në momentin që e kemi marrë këtë vendim si kabinet, unë iu kam drejtuar Zyrës ligjore për të marrë opinionin ligjor se si duhet të veprojmë.

Vendimin që e kemi marrë ne është i datës 2 dhjetor 2022, dhe e obligon ndryshimin e tarifave të zbatueshme nga 1 janari 2023, që i bie se deponia duhet bërë faturimin në lartësi prej 7 euro e 31 cent për ton, që është 2 euro më shumë sesa që ka qenë në dhjetor të vitit 2022.

Rrjedhimisht, ne e kemi të obligueshme ta trajtojmë këtë para muajit janar, dhe meqenëse ka ardhur si pikë shumë e vonshme dhe nuk e kemi një interpretim final të Zyrës ligjore se në cilin akt duhet me e ndryshuar tarifën aktuale, atëherë unë mendoj që sipas të gjitha planifikimeve që ne, do ta kemi këtë gati për seancë. Për ne ishte e domosdoshme që mos ta sjellim në seancë si pikë, por ta tregojmë edhe këtu sot që e kemi këtë vendim, jemi duke e shqyrtuar dhe duke e bërë gati për seancë, në mënyrë që para 1 janarit ta kemi një trajtim të kësaj në mënyrë ligjore.

**Nora Kelmendi** pyeti se a e ka bërë dikush kalkulimin se mbi çfarë baze është bërë ngritja në 6 euro, sepse këtu po thotë 7.31 për ton, ky kalkulimi për ekonomi familjare është 6 euro në muaj, a është kalkuluar disi prej 4.70 që është rritur.

**Donjeta Sahatçiu** dha sqarime shtesë për pyetjen e parashtruar nga parafolësja.

**Leutrim Retkoceri** tha se është edhe një kërkesë prej menaxhmentit të pastrimit, që iu ka drejtuar kryetarit Rama, aksionarëve, është i datës 25 tetor 2022, ku ndërmarrja sipas planifikimit dhe planit të biznesit që e ka paraparë për të pasur mundësi për rentabilitet dhe kthim të normalitetit të gjendjes me grumbullimin e mbeturinave në kryeqytet, ka kërkuar që tarifa e amvisërisë nga 4.70 të bëhet 7.50, d.m.th. për 59% të kësaj rritje, ndërsa tarifa për biznese është kërkuar që nga 6 të bëhet 9.60, nga 7.20 për veprimtari të bizneseve të vogla të bëhet 11.50. D.m.th., afërsisht kërkesa që është nga kompania regjionale e mbeturinave është që rritja të ndodhë në 60%, kjo rritje që është si propozim, është edhe më e ulët, çka do të thotë që nëse mbërrihet me iu përgjigjur kërkesës së ndërmarrjes dhe menaxhmentit, atëherë shifra nuk është kjo që është e propozuar për 1 euro e 30 cent, por është shumë më e lartë për me mbërriri me pasur efikasitet.

**Osman Bllaca** kërkoi sqarime në lidhje me këtë. Në qoftë se e mbajmë seancën më datë 28 dhe po e miratojmë këtë të gjithë, pastaj duhet me e dërguar në MAPL, derisa të kthehet

konfirmimi ligjor, me datën 1 janar 2023, në mënyrë automatike bëhet gjenerimi i faturave për të gjithë komunën. Tash kjo ende nuk është në fuqi. Pa ardhur kjo, tash a mbetet me të vjetrën apo me të renë, këtë është dashur ta miratojmë më herët.

**Donjeta Sahatçiu** tha se nuk kemi mundur me miratuar më herët, sepse më 2 dhjetor 2022, ka ardhur e-maili, që po thotë se prej datës 1 janar hyn në fuqi, gjë që nuk është në rregull.

**Gëzim Sveçla** kërkoi nga nënkryetarja që të merret veprim tjetër, ndoshta me e subvencionuar për janar pastrimin, por ky nuk mund të hyjë në fuqi.

**Donjeta Sahatçiu** tha se nuk ndryshohet rregullorja, ta merrni këtë pikë si informim që ne kemi marrë një vendim, që ne duhet të reagojmë. Nuk e kemi të pranishëm përfaqësuesin e Zyrës ligjore, nuk e kemi një zgjidhje finale se a do të vijmë me një propozim për subvencionim, apo do të vijmë me një zgjidhje për rritje të çmimit. Nuk e kemi të finalizuar, sepse janë ditët e fundit kur jemi marrë me këtë çështje.

**Valbona Makolli** dha sqarime, duke thënë se subvencionim në janar nuk mund të bëjmë, sepse nuk bëhet alokimi i mjeteve, por mirë është që DSHP-ja e ka raportin e mbledhjes së të hyrave që i bëjmë ne.

**Gëzim Sveçla** tha, d.m.th. po flasim që arkëtimi është i ulët, në pamundësi për ta rritur arkëtimin po e rrisim çmimin!

**Donjeta Sahatçiu** theksoi se nuk lidhen këto të dyja me njëra-tjetrën, ai është problem krejt në vete, që duhet ta adresojmë me një plan investim, ky është një vendim që ta kërkon rritjen e deponisë çdo vit nga 1 euro deri në vitin 2027.

**Gëzim Sveçla** pyeti se këto lista ose këto tarifa a mundem me ditë ku janë, çfarë dokumenti është ai që i përmban tarifën.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se kjo është një rregullore e përgjithshme që i përcakton çmimet.

**Gëzim Sveçla** pyeti se a ka numër, a ka emër ajo rregullore, brenda rregullores për menaxhimin e mbeturinave janë këto tarifa, atëherë kemi të bëjmë me plotësim-ndryshim të rregullores, e cila nuk mund të ndodh pa u formuar një komision, sepse çdo vendim që merret për ndryshim të rregullores pa komision ligjërisht është zero.

**Leutrim Retkoceri** tha se është një çështje tjetër sa i përket faturave, Komuna e ka të rregulluar ndryshe çështjen e faturimit, do të thotë Komuna ia paguan kompanisë rajonale "Pastrimi", ndërsa qytetarët ia paguajnë pastaj Komunës.

**Gëzim Sveçla** tha se këto propozime që po i japim asnjëherë nuk po i votojmë, propozimet të cilat vijnë prej KPF-së, në fillim të seancës duhet të dalësh si kryetar i Kuvendit, dhe të thuash KPF-ja propozon që edhe këto pika të futen në rend të ditës, nëse kalojnë këtu, kuptohet.

**Leutrim Retkoceri** dha sqarime lidhur me procedurat për propozimet e pikave të rendit të ditës në KPF.

**Gëzim Sveçla** tha se te propozimi për me e futur si pikë e rendit të ditës "Raporti i punës së Kryetarit", kisha propozuar si propozim shtesë, që në Kuvend të jetë si pikë e dytë e rendit të ditës, pas ekstraktit.

Në bazë të propozimeve të dhëna dhe të votuara njëzëri, kryesuesi konstatoi se u miratua ky

## REND I DITËS:

Faqe3nga10

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa;
2. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për hapjen e kodit buxhetor, nr. 01-400/01-177472/22, dt. 26.07.2022;
3. Propozimvendimi për miratimin e Projektregullores për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë;
4. Propozimvendimi për miratimin e Projektregullores për transparencë;
5. Propozimvendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023;
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Arif Dermishit;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut dhe "Vëllezërit Asllani" SHPK;
8. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objektit të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë;
9. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2023;
10. Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë;
11. Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore;
12. Informatë nga Drejtoria e Kulturës;
13. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, nr. 01-151/01-151637/22, dt. 30.6.2022;
14. Raporti i punës së Kryetarit, për periudhën 7 dhjetor 2021 - 7 dhjetor 2022;
15. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për themelimin e komiteteve të tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-020/02-103516/22, dt. 12.05.2022;
16. Të ndryshme.

#### Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

#### Pika e dytë

Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për hapjen e kodit buxhetor,

nr. 01-400/01-177472/22, dt. 26.7.2022.

Për këtë pikë të rendit të ditës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Valbona Makolli**.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për hapjen e kodit buxhetor, nr. 01-400/01-177472/22, dt. 26.07.2022 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

**Pika e tretë**

**Propozimvendimi për miratimin e Projektregullores për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë.**

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Projektregullores për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Donjeta Sahatçiu**, udhëheqëse e grupit punues për hartimin e kësaj projektregulloreje, bëri të ditur se i kanë mbajtur tri diskutime publike, të cilat për herë të parë kanë qenë në transmetim të drejtpërdrejtë në internet dhe qytetarët kanë mundur që, përveç se t'i shohin ato online kudo që janë, kishin mundësi të na dërgojnë komente në linkun të cilin e kemi publikuar. Diskutime kanë shkuar shumë mirë dhe kemi marrë reagime, pastaj kemi pasur edhe të tjerë që pas takimeve i kanë dërguar komentet e tyre me e-mail. E kemi vonuar paksa shkaku i afatit ligjor, kemi pritur të përfundoj 30 ditëshi, që ka qenë 10 dhjetori, pastaj e kemi finalizuar dhe me Zyrën ligjore.

Si grup, jemi të kënaqur me gjithë procesin që ka shkuar, kemi marrë vlerësime të ndryshme, por edhe palët e interesit kanë qenë të kënaqura me atë se çfarë kemi propozuar. Kemi mbajtur takime me shoqata edhe një herë. Përveç diskutimit publik, jemi takuar edhe një herë me to që t'u tregojmë që komentet e tyre i kemi shqyrtuar dhe iu kemi treguar se çka mund të marrim parasysh dhe çka nuk mund të marrim parasysh, sepse nuk kemi dashtë që ata me qenë të befasuar në një seancë ku mund të miratohet kjo projektregullore.

**Gëzim Sveçla** përshëndeti mënyrën se si ka ardhur deri te kjo projektregullore, mirëpo ai shprehu mendimin se ka me qenë sfidë implementimi në terren, te kjo hyrja në fuqi, se jemi në një fazë kur rregullorja hyn në fuqi, në anën tjetër nuk do të bëjmë gjoba deri në prill, që po i bie se nuk po e zbatojmë rregulloren, në aspektin ligjor po mendoj. Andaj, Zyra ligjore këtë periudhën tranzitore ta sqarojë shumë mirë, në mënyrë që mos të ketë efekte të cilat shkojnë në dëm të Komunës, por në të njëjtën kohë edhe te lokalet hoteliere.

Ai parashtroi pyetjen se a kanë të dhëna për numrin e saktë të lokaleve.

**Donjeta Sahatçiu** u përgjigj, duke thënë se janë rreth 600 lokale të regjistruara, sipas një databaze të cilën e kemi në dispozicion. Ne nuk mendojmë se të gjitha janë të regjistruara, aty sigurisht se ka edhe të regjistruara të cilat janë kafene të vogla nëpër lagje të cilët nuk lëshojnë

muzikë dhe janë vetëm për të shërbyer kafe, çaj etj., të cilat nuk kanë muzikë natën, por duhet t'i shqyrtojmë edhe ato.

**Arben Kçira** u shpreh i pajtimit me idenë e Gëzimit, që te dispozitat kalimtare duhet cekur nenet që kanë qëllim me hy në fuqi pak më vonë, sepse ky 15 ditshi është standard që e marrim prej MAPL-së, nenet që do të hyjnë në fuqi më vonë janë nene në dispozita kalimtare.

**Gëzim Sveçla** tha se sipas nenit 25, 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit, në Zyrën e protokollit regjistrohet në momentin që e përfundon seancën dhe e dërgon.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se vulën e protokollit që hyn si e plotfuqishme, duhet me marrë pas kthimit të ligjshmërisë, aty mundet me qenë pas publikimit në ueb-faqe. Nuk mundesh me e publikuar një vendim në ueb-faqe pa kthimin e përgjigjes së ligjshmërisë nga MAPL se a qëndron apo nuk qëndron në suaza ligjore.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se ndoshta është mirë që rregullorja hyn në fuqi, mirëpo mund të ceket neni 26, nenet sanksionuese fillojnë prej datës 1 mars, 1 prill, kurdo që e vlerëson operatori që mundet me i përfunduar të gjitha.

**Donjeta Sahatçi** tha se neni 23, pika 4 thotë: "Prej momentit të hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje deri më 31 mars 2023, konsiderohet periudhë e vetëdijesimit dhe informimit për subjektet afariste, brenda së cilës periudhë nuk do të aplikohen masat dhe gjobot e parapara me këtë rregullore."

Ajo sugjeroi që të përmirësohet gabimi teknik te nenin 22, pika 3, te fjalia në fund, ku thuhet: " Brenda afatit prej 24 orë", në kllapa është 48, duhet të jetë shifra 24 e jo 48, d.m.th. shkrimi dhe numri nuk përputhen.

**Gëzim Sveçla** vlerësoi se duhet të ceket "ditë të punës", sepse me ardhur ankesa të premtën a mundet Komuna të shtunën brenda 24 orëve, neni 22 pika 3.

**Donjeta Sahatçiu** u shpreh se nga përvoja që e kishim edhe në dy thirrjet e kaluara, ne i kemi trajtuar edhe gjatë vikendit ankesat, d.m.th. i kemi pasur 24 orë. Nuk e kemi cekur specifikisht, por ndoshta duhet me e cekur.

**Osman Bilaca** tha se këtu duhet me shikuar nënkryetare, sepse mundet të shtunën me ardhur, që zakonisht ka muzikë, tash brenda 48 orëve, kujdestaria e Inspeksionit është, por komisioni i ankesave nuk është.

**Donjeta Sahatçiu** tha se neni 23 e trajton vetëm mbylljen e lokaleve, ankesën nëse ty të mbyllet lokali për 8 ditë, që i bie i ke kaluar të gjithë hapat, që duhet të mbyllet lokali dhe ankesa për të është 24 orë.

**Gëzim Sveçla** pyeti se komisioni a është funksional edhe të dielave.

**Donjeta Sahatçiu** bëri të ditur se komisioni është funksional, në kuptimin që kur krijohet nuk shfuqizohet, nuk është funksional një ditë po një ditë jo, punon dhe mblidhet. Ne kemi pasur rast kur për një ankesë jemi mbledhur të dielën. Për ne nuk është asnjë problem me specifikuar këtu a është ditë pune apo kalendarike.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Projektregullores për orarin e punës dhe mbrojtjen nga ndotja akustike në sektorin e gastronomisë, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### Pika e katërt

**Propozimvendimi për miratimin e Projektregullores për transparencë.**

Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e Projektregullores për transparencë, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Osman Bllaca**.

Ai tha se këtë rregullore e kemi hartuar, duke u përpjekur që t'i përfshijmë të gjitha organet e Komunës, duke filluar prej Kuvendit komunal, me të gjithë trupat, kryetarin, nënkryetarët, drejtorët e drejtorive, udhëheqësit e sektorëve dhe të gjithë shërbyesit civilë.

Kjo është me qëllim të rritjes së transparencës dhe aty ku kemi transparencë me forcuar akoma më shumë.

**Nora Kelmendi** tha se Raporti i punës së drejtorëve nuk ishte paraqitur, e keni vendosur të nënkryetarëve, të Kuvendit, por i drejtorëve nuk ishte përfshirë.

**Mirsad Vitia** pyeti se a është dashtë me u përfshirë edhe ndërmarrjet publike lokale.

**Osman Bllaca** tha se do t'i bashkëngjisim raportet mujore të drejtorëve.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se rregullorja për gastronomi ka qenë mënyrë e mirë se si duhet me u miratuar apo ndryshuar një rregullore, dhe është mirë që si ekzekutiv me e marrë si shembull.

**Donjeta Sahatçiu** bëri të ditur se në takimin që e kanë pasur për rregulloren për gastronomi, e ka përmendur që e ka marrë si përgjegjësi, vetiniciativë, që në këtë proces të rregullores për gastronomi t'i identifikohen problemet në hapa ose mundësitë për të përmirësuar procesin, ashtu që ta krijojmë një proces të çartë, në mënyrë që çdo rregullore të kalojë në atë proces dhe ta përmirësojmë modelin të cilin e kemi aktualisht.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për miratimin e Projektregullores për transparencë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### Pika e pestë

**Propozimvendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023.**

Kryesuesi tha se në mungesë të drejtoreshës së pronës, Doruntinë Maloku, kjo pikë diskutohet në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për miratimin e listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2023, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

#### Pika e gjashtë

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajjtshme komunale me pronën e paluajjtshme në pronësi të Arif Dermishit;**

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajjtshme komunale me pronën e paluajjtshme në pronësi të Arif Dermishit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajjtshme komunale me pronën e paluajjtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut dhe "Vëllezërit Asllani" SHPK.**

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajjtshme komunale me pronën e paluajjtshme në pronësi të Shukrije Bajgorës, Muhamed Sadikut, Adnan Sadikut dhe "Vëllezërit Asllani", SHPK, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e tetë**

**Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajjtshme të Komunës për ndërtimin e objektit të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë.**

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajjtshme të Komunës për ndërtimin e objektit të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2023.**

**Leutrim Retkoceri** tha sa i përket formimit të grupit punues të planit të punës së Kuvendit të Komunës, këtë herë mendoj se mund ta bëjmë bashkërisht edhe më të saktë edhe me i paraparë disa raste se kur parashihen këto vendime të jashtëzakonshme, kur mundemi me i paraparë planet dhe punët që mund t'i bëjë Kuvendi, në mënyrë që me e pasur të respektuar planin e punës të paktën 70-80% të tij.

Andaj, propozoj që në kuadër të tij të jetë edhe rregullorja, dhe ky plan i punës me u bërë bashkë. Unë e di që është, por edhe rregullorja për disa çështje për neve është hendikep në punë, kështu që nëse ishim mbledhur nga fundi i janarit, ky grup dhe një grup për rregullore, mendoj që e kishim bërë punën më të mirë me pas një plan të punës sa më të saktë të Kuvendit.

**Gëzim Sveçla** shprehu mendimin se ky është vendimi më kot që e marrim ne këtu për këtë planin e punës, të cilit farë nuk i përmbahemi. Ne nuk do të propozojmë fare anëtar për planin e punës, është krejt kot, as nuk respektohet, as nuk bëhet asgjë.



Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për formimin e grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2023, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

**Pika e dhjetë**

**Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë.**

**Leutrim Retkoceri** tha se është njëri prej materialeve që nuk është vetëm informatë, këtë herë ka mundur të jetë edhe raportim, për shkak se po bëhet pas aprovimit të planit të biznesit që e ka bërë ndërmarrja më herët se 31 tetori, dhe është më komplet për dallim prej atyre informatave të ndërmarrjeve deri tash.

**Milazim Vitija** propozoi që këtë pikë me e shtyrë pas marsit, pasi të mbyllet viti fiskal, për shkak se janë raportet e ndërmarrjeve, kjo informatë nuk e di sa na hyn në punë, sepse raportimet bëhen pas mbylljes së vitit fiskal, d.m.th. pas marsit e tutje.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informatë lidhur me Raportin vjetor të komisionit të aksionarëve të NPL "Trafiku Urban", SHA, Prishtinë dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore.**

**Plator Gërdovci** tha se e kemi përgatitur materialin, e kemi dërguar me kohë, por këtu kam ardhur më shumë për ta respektuar edhe KPF-në, edhe juve kryesues, dhe me dhënë ndonjë informatë shtesë, nëse ka nevojë.

**Gëzim Sveçla** u shpreh se e vlerësojmë drejtorin për respektin që ka treguar ndaj KPF-së.

**Leutrim Retkoceri** theksoi se si informatë është plotësisht e mirë sa i përket Kuvendit, por çka është me rëndësi të referimi i pikës, duhet të shtohet aty që është informatë nga Drejtoria e Bujqësisë për mbjelljet vjeshtore, për shkak se edhe Hortikultura e mbjellë ndonjë pemë.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

**Pika e dymbëdhjetë**

**Informatë nga Drejtoria e Kulturës.**

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informatë nga Drejtoria e Kulturës dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.**

**Pika e trembëdhjetë**

**Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, nr. 01-151/01-151637/22, të dt. 30.06.2022;**

Faqe9nga10

**Besianë Musmurati**, sa për informim, tha se kemi filluar dy konkurse, konkursin për shkolla të mesme paraprakisht, pastaj për shkolla fillore. Për shkolla të mesme prej 6 pozitave vetëm 1 pozitë ka pasur mjaftueshëm aplikantë që i kanë plotësuar kushtet dhe është zhvilluar procedura e intervistimit, ka qenë për gjimnazin "Sami Frashëri", pastaj për shkolla fillore ka pasur mjaftueshëm aplikantë, por në ndërkohë anëtarja e komisionit nga DKA-ja ka pasur probleme shëndetësore dhe ka dhënë dorëheqje, andaj nuk kemi pasur mundësi me vazhduar. Për këtë arsye e kërkova në mënyrë urgjente me e futur për këtë seancë këtë propozimvendim. Anëtarja që po e propozojmë tash është Fitnete Tutuli, që ka me zëvendësuar Arbena Aliun.

**Gëzim Sveçla** pyeti për periudhën pas përfundimit të intervistës deri te shpallja e fituesit.

**Besiana Masmurati** dha sqarime lidhur me pyetjen.


**Arben Kçira** informoi se e ka përgatitur propozimvendimin, por nuk ka qenë në dijeni që do të propozohet sot.

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në kryeqytetin e Republikës së Kosovës, nr. 01-151/01-151637/22, të dt. 30.6.2022 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

*Mbledhja përfundoi në orën 11:30.*

**Procesmbajtësi**  
**Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit**  
**Fehmi Kupa**



---

Faqe10nga10